



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister  
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



# Statistikat e Hotelerisë

## Tetor 2022

**Prishtinë, 30.12.2022:** Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e Statistikave të Hotelerisë Tetor, 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin me të dhëna për aktivitetin Hotelier në Kosovë, lidhur me numrin e vizitorëve vendor dhe të jashtëm dhe net qëndrimet e tyre. Ky publikim statistikor paraqet të dhëna statistikore për muajin Tetor të vitit 2022.

Burimet e të dhënave janë hotelet dhe njësitë tjera akomoduese të klasifikuara në aktivitetin e hotelerisë dhe turizmit sipas NACE-Rev.2.

Qëllimi i publikimit është që të vejë në dukje tendencën e zhvillimit të këtij aktiviteti ekonomik në Kosovë.

Duke u bazuar në kërkesa të vazhdueshme nga shfrytëzues të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm për të dhëna dhe informacione statistikore si dhe duke shfrytëzuar rekomandimet dhe manualët e EUROSTAT-it mbi indikatorët që duhet të publikohen për statistikën e hotelerisë, kemi prezantuar informacione me interes.

Ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së, dhe si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund ti dërgoni në adresën elektronike:  
[infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net).

Publikimin e përgatitën :

**Ismail Sahiti** - Zv. Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike  
**Mensure Çerkezi** - Zv. Shefe e sektorit  
**Mergime Shala** - Zyrtare për Statistika të Ndërmarrjeve  
**Sulltane Gashi** - Zyrtare për Statistika Ekonomike

Dhjetor, 2022

Zv. Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,  
z. Ilir T. Berisha

Në Republikën e Kosovës, në muajin Tetor 2022, krahasuar me muajin Tetor 2021, numri i vizitorëve vendorë ka pasur rritje për 32.1% ndërsa net qëndrimet e tyre janë rritur për 34.6%

Në muajin Tetor 2022, krahasuar me muajin Tetor 2021, numri i vizitorëve të jashtëm ka pasur rritje për 40.2% ndërsa numri i net qëndrimeve të tyre është rritur për 55.3%

**Tab. 1: Numri i vizitorëve dhe net qëndrimet e tyre sipas regjioneve**

	Total			Vendor			Të jashtëm		
	X 2021	X 2022	Indeksi	X 2021	X 2022	Indeksi	X 2021	X 2022	Indeksi
			<u>X 2022</u> X 2021			<u>X 2022</u> X 2021			<u>X 2022</u> X 2021
	<b>Vizitorët</b>								
<b>Republika e Kosovës</b>	<b>30.669</b>	<b>42.050</b>	<b>137,1</b>	<b>11.722</b>	<b>15.489</b>	<b>132,1</b>	<b>18.947</b>	<b>26.561</b>	<b>140,2</b>
Gjakovë	496	493	99	160	80	50	335	412	123
Gjilan	1.024	1.607	157	696	1.082	155	328	525	160
Mitrovicë	4.377	2.532	58	1.861	1.032	55	2.517	1.500	60
Pejë	3.546	4.307	121	1.818	2.106	116	1.728	2.202	127
Prizren	4.848	9.709	200	1.836	4.883	266	3.012	4.826	160
Prishtinë	13.710	19.071	139	3.176	3.344	105	10.534	15.727	149
Ferizaj	2.668	4.330	162	2.174	2.961	136	493	1.369	277
	<b>Netqëndrimet</b>								
<b>Republika e Kosovës</b>	<b>47.803</b>	<b>70.955</b>	<b>148,4</b>	<b>15.796</b>	<b>21.258</b>	<b>134,6</b>	<b>32.006</b>	<b>49.697</b>	<b>155,3</b>
Gjakovë	782	830	106	246	159	65	537	671	125
Gjilan	1.282	1.770	138	783	1.172	150	500	598	120
Mitrovicë	4.327	2.490	58	1.838	997	54	2.489	1.493	60
Pejë	7.037	13.594	193	2.538	5.005	197	4.498	8.590	191
Prizren	6.762	13.340	197	2.274	5.255	231	4.487	8.084	180
Prishtinë	22.057	33.256	151	4.851	5.032	104	17.206	28.224	164
Ferizaj	5.556	5.675	102	3.266	3.638	111	2.290	2.037	89

**Tab. 2: Numri i vizitorëve dhe net qëndrimet e tyre, sipas shteteve prej nga vijnë**


	Vizitorët			Netqëndrimet		
	X 2021	X 2022	Indeksi	X 2021	X 2022	Indeksi
			$\frac{X\ 2022}{X\ 2021}$			$\frac{X\ 2022}{X\ 2021}$
<b>Të jashtëm</b>	<b>18.947</b>	<b>26.561</b>	<b>140,2</b>	<b>32.006</b>	<b>49.697</b>	<b>155,3</b>
Austria	655	567	87	899	727	81
Belgjika	399	411	103	554	612	110
Bosna & Hercegovina	141	184	131	220	304	138
Britania e Madhe	504	831	165	880	1.186	135
Franca	331	477	144	565	810	143
Gjermania	2.072	2.860	138	4.188	7.563	181
Greqia	145	248	171	237	618	261
Holanda	178	620	347	288	996	346
Italia	572	816	143	1.296	1.980	153
Kroacia	1.030	945	92	1.721	1.494	87
Mali i Zi	342	528	154	453	678	150
Maqedonia	709	1.336	188	1.179	1.657	140
Polonia	119	360	302	322	735	229
Serbia	698	964	138	1.233	1.796	146
SHBA	758	1.342	177	1.187	3.116	262
Shqipëria	4.606	5.739	125	6.135	9.761	159
Slovenia	296	260	88	512	384	75
Spanja	225	282	125	289	769	266
Turqia	1.133	1.844	163	2.149	2.974	138
Zvicra	2.023	2.288	113	3.984	4.070	102
<b>Të tjera</b>	<b>2.010</b>	<b>3.658</b>	<b>182</b>	<b>3.715</b>	<b>7.466</b>	<b>201</b>

Në Tetor 2022 numri më i madh i vizitorëve të huaj është nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra.

**Tab. 3: Shfrytëzimi i kapaciteteve hoteliere sipas shtretërve**

Shfrytëzimi i kapaciteteve	X 2021		X 2022	
Republika e Kosovës		12,9		19,1
Gjakovë		4,9		5,2
Gjilan		5,8		8,0
Mitrovicë		19,0		10,9
Pejë		9,8		18,8
Prizren		8,2		16,2
Prishtinë		18,2		27,4
Ferizaj		15,8		16,1

Sipas anketës, kapaciteti i shfrytëzuar në nivel vendi sipas numrit të shtretërve në Tetor 2022 është 19.1%.

**Fig. 1: Numri i vizitorëve dhe net qëndrimet e tyre për periudhat 2021 dhe 2022**

## Shpjegime Metodologjike

### Objektivi

Objektivi kryesorë i Hulumtimit të Statistikave të Hotelerisë është paraqitja e trendëve nëpër periudha mujore në këtë sektor në Kosovë. Këta indikatorë ekonomik mundësojnë që të dhënat të jenë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standardet Evropiane për statistikat mujore.

### Përkufizimet

#### Hotel

Njësi hoteliere është një ndërmarrje, e cila në biznes regjistër është e regjistruar në aktivitetin e hotelerisë. Po ashtu edhe njësitë hoteliere në kuadër të bizneseve private që janë të përfshira në këtë grup. Varësisht nga shërbimet që kryejnë këto njësi janë të ndara në hotele, motele etj.

#### Turizëm

Turizmi përfshinë aktivitetet e personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende të ndryshme nga vendi i qëndrimit të tyre të zakonshëm për një periudhë jo më të gjatë se një vit kalendarik dhe qëllimi i këtij udhëtimi është kohë e lirë, biznes e të tjera.

#### Vizitor

Vizitor quhet një person i cili kalon të paktën një natë në një strukturë hoteliere në vendin që ai viziton. Për qëllime të statistikave të turizmit, termi "vizitor" përfaqëson një "person" që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi që ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj. Ai mund të jetë vendor apo i jashtëm.

Vizitor vendor është personi me vendbanim të përhershëm në Kosovë, por i cili qëndron për së paku një natë në një vend tjetër në Kosovë.

Vizitor i jashtëm konsiderohet personi me vendbanim të përhershëm jashtë Kosovës, por i cili qëndron përkohësisht në Kosovë për së paku një natë.

#### Net-qëndrimi

Një vizitor që kalon një natë brenda një objekti hotelier njihet si net-qëndrim në hulumtimin tonë.

## Metodologjia dhe shtrirja e anketës

Anketa e Hotelerisë zhvillohet në baza mujore në tërë territorin e Kosovës. Të dhënat grumbullohen nëpërmjet zyrave rajonale statistikore (gjithsej 7 sish), në mënyrë elektronike dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë të njësisve raportuese.

Bazuar në programin statistikor të ASK-ës, merren të dhëna mbi numrin e hoteleve, numrin e të punësuarve, kapacitetet për vendosje (dhoma, shtretër), numrin e vizitorëve dhe netët e qëndrimit sipas muajve si dhe vizitorët e jashtëm sipas vendeve.

Si kornizë për krijimin e mostrës së hotelerisë është përdorur Regjistri i kapaciteteve hoteliere në Kosovë i cili përmban 506 njësi akomoduese. Mostra e vitit 2022 për anketën e hotelerisë përmban 243 njësi akomodimi, të ndara sipas regjioneve. Në muajin Tetor 2022 shkalla e përgjigjeve në këtë anketë ishte 86%, 209 hotele kanë dhënë përgjigje në anketë. Të dhënat në këtë publikim janë të ngritura në pesha dhe paraqesin rezultate në nivel vendi.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.